

## Permbledhje joteknike e aktivitetit

*“Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytezim  
ne qiell te hapur dhe nga guroret”*



Subjekti : “Ikeral” sh.p.k  
Hartoi: “EKO-STUDIO-PROJEKT”sh.p.k  
Administrator : Shkelzen MADANI



Tirane, 2022

## PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

### 1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

### 2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

### 3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

### 4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

### 5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME



## HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrushem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:  
**“Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur dhe nga guroret”**

## BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedisete caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisore te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 266 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



## 1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

### ➤ Profili i propozuesit

Subjekti: "Ikeral" shpk, është regjistruar pranë QKB me Nr. NIPT J64103811M me datë 01/07/1996 kryen aktivitetin "Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytezim në qiell të hapur dhe nga guroret" për të cilin ka patur një leje të meparshme mjedisi. Në bazë të lejes së shfrytezimit që operatori disponon **Nr.1161/6 datë 20.02.2012** kërkon të kryejë procedurat për pajisje me Leje Mjedisi tipi B të re.

Procesi që do të kryhet në këtë aktivitet është prodhim argjile me karriere .

-Tipi dhe sasia e lëndës së parë është argjila.

-Burime të tjera të konsumuara janë ato njerzore, makinerit e paisjet, dizel me të cilin do të punojnë në karriere sonda e shpimit, makinarit e ngarkimit si eskavoret, fadromat dhe makinat e transportit të prodhimit deri në destinacion.

Lenda e parë argjilore merret në vendburimin "Krekez-6", me vendodhje në Fshatin Nivice, komuna Lukovë, Rrethi Sarandë, qarku Vlorë. Kjo është argjile me orgjinë sendimentare aluvionale- kenetore. Lenda e parë në kompleksitetin e saj klasifikohen si lende argjilore por në rast se do të përcaktojmë me saktë keto depozitime janë ndershtresa sureresuargjile të cilat i grupojmë në keto shtresa:

- Rera dhe surera me ngjyrë gri, boje qielli me copera të ranoreve të flishit.
- Surera, rera dhe argjilet.
- Argjila dhe surera ngjyrë kafe bezhe.

### ❖ **Lloji i mineralit**

Pakaja argjilore produktive në tavan ka një mbulesë të përfaqësuar nga deluvione. Mesatarisht në të gjithë vendburimin pakoa produktive ka një trashësi prej 5-10m.

### ❖ **Plasticiteti**

Një veti tjetër e argjilave që përcakton përdorimin e tyre në prodhimin e qeramikes së trashë është dhe plasticiteti. Me plasticitet kuptohet aftësia e masës argjilore për të patur kufi e intervale plasticiteti dhe në lagështirë perkatëse të japë gjendjen e formimit. Me rritjen e plasticitetit të argjilave rritet lidhshmëria e tyre. Pësha volumore nga analizat e kryera rezultoi 1.985. Ky koeficient është përdorur në llogaritjen e rezervave.

Radha e shfrytezimit si zonë kushtëzohet nga vendosja e mbulesës dhe sheshit të depozitimit. Shfrytezimi fillon nga lart-poshtë. Në këtë sipërfaqe nuk ka asnjë objekt banimi, linjë tensioni të lartë, linjë telefonike apo burime të tjera natyrore që mund të demtohen gjatë shfrytezimit. Prodhimi prej 30 000 m<sup>3</sup> argjile që do të transportohet nga karriera (nga njëra prej karrierave) deri në fabrikën e tullave, distancë kjo prej rreth 5 km. Ky subjekt do të ketë në punë 2-3 kamione me kapacitet karrocierie 20 m<sup>3</sup> si dhe një ekskavator.

### ❖ **Kerkesat e përdorimit të tokës si dhe karakteristikat e tjera të projektit:**

Sipërfaqja e tokës ku do të zbatohet projekti është prone private në territorin e komune Lukovë. Sipërfaqja e tokës që do të shfrytezohet për prodhim argjile gjatë aktivitetit të prodhimit dhe në mbyllje të saj nga subjekti do të sistemohet dhe rehabilitohet sipas projektit të zbatimit të



miratuar ne AKBN, me qellim krijimin e nje peisazhi, duke marre ne konsiderat floren vendase.

#### ❖ Pershkrimi i sistemit te shfrytezimit

Per zgjedhjen e menyres me te pershtateshme dhe me te leverdishme te shfrytezimit te vendburimit jane marre ne konsiderate keto faktore kryesor:

- Formen e vendburimit.
- Vetite fiziko - mekanike te shkembijeve qe ndertojne vendburimin.
- Kushtet tekniko - minerare te vendburimit.
- Kushtet hidrogjeologjike te vendburimit.
- Sasia dhe cilesia e rezervave te depozitimeve argjilore

Elementet e sistemit te shfrytezimit qe perdoren ne kete objekt jane:

- Lartesia e shkalles se karrieres eshte 5-10 m
- Gjeresia e sheshit te punes nga 60-80 m ne 40-60 m
- Thellesia e karrieres: 5-10m
- Kendi i shkalles se punes 60°
- Prodhimi ditor 250 m<sup>3</sup>
- Rendimenti i punonjesve 250 m<sup>3</sup>/punonjes



#### ❖ Percaktimi menyres se shfrytezimit te argjilave

Percaktimi i menyres se prodhimit te argjilave ne vendburimin e projektuar u be me metoden e krahasimit te tre menyrave te mundshme te shfrytezimit, si.

1-Shfrytezimin me karriere (Punime siperfaqesore)

2-Shfrytezimin me punime nentokesore

3-Shfrytezimin me punime te kombinuara me punime nentokesore dhe punime siperfaqesore.

Duke krahasuar menytrat e shfrytezimit te permendura me siper, ky vendburim do te shfrytëzohet me karriere, punime siperfaqesore.

Avantazhet e shfrytezimit te vendburimit me karriere:

- Kosto prodhimi te ulet.
- Realizohet prodhim pa kufizim, sipas kerkesave te konsumatorit
- Lejon shkalle te larte te prodhimit me ane te copetimit te masivit, ngarkimin e prodhimit dhe transportin deri ne destinacion
- Ka siguri te larte ne pune



❖ **Shkriferimi argjilave ne karriere**

Argjila ka fortesi te vogel dhe nuk ka nevoje per perdorimin e punimeve te shpim plasjes dhe shperthimit per shkriftimin e tyre. Mbulesa vegjetale gjithashtu eshte me fortesi te vogel dhe nuk ka nevoje per perdorimin e punimeve te shpim plasjes dhe materialeve plasese dhe shperthyese. Per shkriferimin e argjiles dhe mbuleses vegjetale do te perdoret forca mekanike e koves se eskavatorit.

❖ **Ngarkimi prodhimit**

Ngarkimi argjilave te prodhuara ne sheshet e shkalleve do te behet me ekskavator kater pilar me zinxhire me gjatesi krahu 8m me volum kove 1m<sup>3</sup>.

Mjeti ngarkimit vendoset ne sheshin e poshtem te shkalles.

❖ **Transporti argjilave nga sheshet e shkalleve ne fabrike**

Prodhimi prej 300 000 m<sup>3</sup> argjile, nga sheshet e shkalleve deri ne destinacion fabriken e subjektit "Ikeral" Sh.p.k do te pershkoje nje distance jo te madhe. Duke patur parasysh vellimin e koves se eskavatorit prej 1m<sup>3</sup>, atehere vellimi i karrocise se automjetit qe zoteron shoqeria "Ikeral" Sh.p.k eshte 20 m<sup>3</sup>.

❖ **Sigurimi teknik ne proceset e punes per hapjen dhe shfrytezimin e argjilave ne Krekez-6**

Punimet ne karriere jane plotesisht te mekanizuara. Do te punoje nje ekskavator dhe 2 automjete. Punonjesit qe drejtojne mjetet duhet te jene te pajisur me deshmi profesioni per perdorimin e ekskavatorit dhe te automjetit. Gjate kryerjes se punimeve te shfrytezimit ekskavatori nuk duhet te afrohet prane skarpates aq sa te mos rrezikohet te rreshqase. Gjate levizjes se tij ne sheshet e karrieres duhet te zgjidhet rruga me qellim qe te mos ngeci ne ndonje vend, por te kaloje ne rruge me bazament ose ta krijojete ate. Gjate ngarkimit kova e ekskavatorit nuk duhet te kaloje asnjehere mbi kabine dhe automjeti duhet te vendoset anash ose mbrapa ekskavatorit. Asnjehere nuk duhet te punohet me ekskavator dhe automjet kur ato nuk jane ne gatishmeri teknike.

Duhet te zbatohet rregullorja e sigurimit teknik per punimet ne qiell te hapur dhe ajo e perdorimit te makines. Duhet te zbatohen parametrat e llogaritur te sistemit, sidomos kendi i punes ne shkalle dhe kendi i shuarjes se shkalles.

**2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

Aktiviteti do te zhvillohet ne qarkun e Vlores , rrethi Sarande, ne komunen Lukove ne fshatin Nivice. Vlora ndodhet pergjate brigjeve shqiptare te detit Adriatik dhe Jon ne pjesen lindore te ngushtices se Otrantos, e rrethuar nga ultesirat e maleve Cerauniane. E percaktuar ne nje sipërfaqe prej 647,94 km<sup>2</sup>, Bashkia Vlorë përfshihet në qarkun e Vlorës si pjesë e Rajonit Jugor të Shqipërisë dhe përbëhet nga njësitë administrative ngjitur Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë, Shushicë dhe Vlorë. Bashkia shtrihet nga gryka e Vjosës në veri pergjate Lagunes së Nartës deri në Qafën e Llogarasë në jug. Ai gjithashtu rrethon gadishullin e Karaburunit dhe ishullin e Sazanit në perëndim me lumin Shushicë-Vlorë që përbën kufirin e tij lindor. Zonat e mbrojtura përfshijnë Parkun Detar Karaburun-Sazan, Parkun Kombëtar të Llogarasë dhe Peizazhin e Mbrojtur Vjosë-Nartë. Bashkia Sarandë përfshihet në qarkun e Vlorës si pjesë e Rajonit Jugor



të Shqipërisë dhe përbëhet nga njësitë administrative ngjitur me Ksamilin dhe Sarandën. Sipërfaqja e përgjithshme e saj është 58,96 km<sup>2</sup>. Fshati Nivice ndodhet në rrethin e Sarandës në rrëze të malit Shëndëlli në pjesën lindore të tij në lartësi 400 m mbi nivelin e detit. Ka 260 shtëpi dhe rreth 1600 banorë. Është fshati i parë që takon në rrugën nacionale Sarandë-Vlorë gjatë bregut të detit në një distance rreth 14 km prej qytetit të Sarandës.

#### ❖ Kordinatat e objektit në sistemin Gaus Kruger

<u>X</u>	<u>Y</u>
4421670	4413595
4421540	4413660
4421785	4414110
4421880	4414035

#### ❖ Klima

Vlora bie nën periferinë e zonës së klimës mesdhetare të verës së nxehtë me një temperaturë mesatare vjetore prej 16,9 °C. Vera në Vlorë është e thatë dhe e nxehtë ndërsa dimrat përjetojnë temperatura mesatare dhe mot të ndryshueshëm me shi. Muaji më i ngrohtë është gushti me një temperaturë mesatare që rritet në 26,8 °C . Në të kundërt, muaji më i ftohtë është janari me një temperaturë mesatare që bie në 7,9 °C (46,2 °F). Vlora ka një klimë me diell me një mesatare prej 3,358 orë me diell në vit, duke e bërë atë një nga zonat më me diell në Mesdheun Lindor.

Relievi i bute ka pamjen e një pllaje të valezuar, vende-vende pak të thyer me lugina të buta të formuara nga proskat e rrjedhjes së ujërave atmosferike. Zona është në përgjithësi e pasur me ujra, pranë kalon lumi Erzen që derdhet në dete dhe janë ndertuar disa ujembledhësa të cilat plotësojnë kërkesat e komunitetit për ujë të tokave bujqesore.

#### ❖ Flora dhe fauna

Pyjet e zonës ofrojnë mjedise të favorshme për rritjen e bimëve dhe kafshëve të ndryshme. Kultivohen bimë të ndryshme bujqesore si perime, drithëra, kultura foragjere etj, gjithashtu kultivohen druret frutore të zonës së Mesdheut si: agrumet (portokallet, limonat, mandarinat) dhe ullinjtë. Vreshtaria ze vend të rëndësishëm.

Bimet barishtore dhe eterovajore që shërbejnë në mjekësinë popullore dhe farmaceutike shtrihen nga zona fushore e deri në atë malore.

Në zonën e shkurreve rritet valanidhi dhe perralli, të njohur për vlerat kurative.

Në lartësinë 800m mbi nivelin e detit, shtrihet zona e dushkut. Mbi 800m mbi nivelin e detit gjendet zona e pishave dhe bredhit si dhe bushi e shtogu.

Kullotat subalpine gjenden në lartësinë 700-1800m.

Fauna dhe eritrofauna është e pasur në lloje në gjithë zonën: sorkadhja, derri i eger, ujku, cakalli dhelpra, lepuri i eger (sidomos në pyllin e Llogorait), eritrofauna e pasur si në toke



ashtu edhe ne ujera: qukapiku, harabeli, mellenja, laraska, zhgaba, skifteri, petriti, thellezat, pellumbat e eger, shapkat (liqeni i Orikumit). Jo rralle shfaqen dhe delfinet e Mesdheut.

Zona e Vlores pret te pakten 33 lloje qe meritojne mbrojtje prej te cileve 14 te vleresuar si te rrezikuar per t'u zhdukur, si foka murgeshe mesdhetare (Monachus Monachus), breshka (Caretta Caretta), tritoni i kreshperuar (Triturus Cristatus) pelikani me krrela (Pelecanus Crispus), shqipja me bllama (Aquila clanga). Ne dimer me shume se 23% e gjithë zogjve ujore te Shqiperise strehohen ketu.

### **3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

#### **❖ Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)**

Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### **❖ Shkarkime ne uje**

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk shkaktohet ndotje e ujerave nentokesore dhe as ne ujrat siperfaqesore. Duke iu referuar natyres se aktivitetit nuk kemi shkarkime me karakter ndotes. Shkarkime do te kemi vetem ne rrjetin e kanalizimeve te zones te cilat do te gjenerohen nga nyjet sanitare. Shkarkimet do te jene brenda normave te lejuara referuar Vendimit Nr.177, date 31.03.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese."

#### **❖ Emetimet ne ajer**

Emetime ne ajer nga funksionimi i ketij aktiviteti do te jene te pranishme por nuk do te jene shqetesuese dhe ne nivele te larta. Kryesisht do te kemi emetime nga mjetet e punes ne norma te vogla sepse jane ne kushte shume te mira teknike. Nga ky aktiviteti mund te kemi gjenerime te lehta pluhuri. Jane emetime te lehta sepse argjila vete nga karakteristikat e saj ka nje lageshti te caktuar plus operatori do te spuçoje me uje duke ulur keshtu ngritjen e pluhurave.

#### **❖ Zhurmat dhe vibrimet**

Zhurma do te gjenerohen nga procesi i punes, por keto zhurma jane brenda normave te lejuara per mjedise pune. Nuk do te gjenerohen vibrime te ndjeshme, vibrime minimale mund te gjenerohen si pasoje e punes se mjeteve ose te punimit te siperfaqeve per shfrytezim. Vibrimet nuk do te jene te larta dhe ne kete menyre ato nuk do te demtojne habitatet ne afersi te rruges automobilistike. Gjithashtu karriara eshte ne nje largesi te konsiderueshme nga banesat.

#### **❖ Ndikimet ne flore dhe ne faune**

Duke iu referuar natyres se aktivitetit nuk kemi ndikime negative ne flore edhe faune. Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk i prek as ne menyre te drejteperdrejte as ne menyre te terthorte. Drejtuesit e shoqerise do te shtojne gjelberimin rreth perimetrin duke ulur edhe ato pak ndikime totalisht te paperfillshme ne mjedis.

#### **❖ Mbetjet e prodhuara**



Shfrytezimi argjilave me kariere do te prodhoje sasi te vogel mbetjesh. Mbetje nga procesi do te perdoren per rehabilitim te siperfaqeve, ndersa mbetjet e gjeneruara nga punonjesit do te grumbullohen dhe do te depozitohen ne vendet e percaktuara nga pushteti lokal. Mirembajtja e makinerive realizohet ne servise te ndryshem, rrjedhimisht nuk do te kemi mbetje te vajrave dhe te gomave.

❖ **Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne toke**

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasojat ne mjedis
1	Ngjeshje e pjesshme e tokes nga levizja e mjeteve te punes dhe te automjeteve te transportit si kamione etj.	Ngjeshja e tokes nga levizja e automjeteve dhe mjeteve gjate punimeve te rikonstruksionit dhe atyre te reja do te limitohet brenda siperfaqes se kerkuar.
2	Erozion minimal ne kohe me reshje ne pjeset anesore te karrieres.(buzet e karrieres)	Shpatet e karrieres me pjerresi 40°, behet shkak qe grimcat e tokes te ekspozohen ndaj agjenteve atmosferike duke u shkeputur dhe levizur kryesisht drejt brendesise se karrieres dhe trupave ujore si proska e perrenj ne afersi te objektit.

❖ **Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne ajer**

Nr.	Ndikimi i mundshem	Pasojat ne mjedis
1	Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet, ngarkim transportit.	Sasia e gazeve e NOx dhe SOx qe do te shkarkohet eshte standart i teknologjise se automjeteve qe do te perdoren gjate punimeve te parashikuara.
2	Emetim zhurmash nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes.	Objekti eshte i distancuar nga qendrat e banuara, keshtu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk do te krijojte probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsesi operaconet e punes do te jene te limituara ne kohe

**4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**

Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte shenuar.

- Trajnim te punonjesve dhe masa te pergjithshme te mbrojtjes se mjedisit.
- Zbatim I udhezimeve per mbrojtjen dhe ruajtjen e bimesise dhe dherave siperfaqesore per te siguruar qe ky material te perdoret per mbulimin e zonave te zhveshura.
- Identifikimi I zonave te erozionit per shkak te punimeve te kryera dhe marrja e masave ndaj tyre.
- Sigurimi qe mbetjet te trajtohen sipas planit te parashikuar.
- Sistemimi I materialeve ne vende te caktuara.
- Te merren masa dhe te kryhet rehabilitimi i mjedisit ne rastet e ndonje aksidenti.
- Te kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike te agregateve dhe mjeteve te transportit.

- Te kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen kanalet kulluese ne territor.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, si dhe me efektet pluhurave, zhurmave, vibrimet etj në jetën e tyre të përditëshme si dhe të merren masat e duhura për monitorimin në vazhdimësi të tyre me aparaturat dhe instrumentet e nevojshme.
- Evadimi i mbetjeve te gjeneruara si nga aktiviteti ashtu edhe nga aktiviteti i punonjesve ashtu sic e parashikon legjislacioni aktual ne fuqi.
- Respektimi i koordinatave dhe shfrytëzimi vetem ne sipërfaqen e dhene ne lejen e shfrytëzimit.

## 5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- Te zbatohen rregullat e sigurimit teknik në punë. Te punohet për krijimin e kushteve optimale të punës per punonjesit dhe manovratorët.
- Masa e dheut qe del nga operacionet e zbulimit te shkëmbit, te sistemohet ne nje vend te caktuar ne objekt dhe te perdoret me pas per qellime rehabilitimi.
- Transpoti i materialit inert te behet me mjete te pastra, gjate transportit mjetet transportuese te mbulohen me mbulesa te cilat parandalojne rrjedhje te materialit ne rruge dhe emetimin e pluhurave.
- Subjekti te kujdeset per te menaxhuar mbetjet e krijuara nga veprimtaria e personelit te punes, duke i transportuar ne menyte te rregullt ne vend grumbullimet te caktuara nga pushteti vendor.
- Te kontrollohen kushtet teknike te mjeteve te punes ne mnyre periodike per te evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve ne mjedis, emetimin e gazeve dhe zhurmave te teperta te shkaktuara nga avari teknike te mjeteve.
- Sherbimi i automjeteve, ruajtjes se lubrifikanteve dhe pjeseve te automjeteve te behen ne vend ete tilla qe te evitojne ndotjen ne mjedis.
- Punonjesit te njihen ne mnyre periodike me kushtet e Lejes Mjedisore dhe pasojat e moszbatimit te tyre ne mjedis.
- Te pastrohen dhe mirembahen ne vijueshmeri, kanalet e drenazhim/kullimit te ujrave sipërfaqesore